

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 05/2009 i Misionit të OSBE-së në Kosovë mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 1 tetor 2009 – 31 dhjetor 2009

Pikat kryesore

- Kuvendi i Kosovës kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të heqin dorë nga njëri mandat, në rastet kur ata ushtrojnë dy funksione
- Kuvendi emëron anëtarët për bordin e Radio dhe Televizionit të Kosovës
- Kuvendi ratifikoi marrëveshjen për demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Ish Republikës Federale të Maqedonisë
- Kuvendi miraton buxhetin e Kosovës për 2010
- Kuvendi has në vështirësi në sigurimin e kuorumit gjatë seancave plenare

1. Historiku

Raporti i 65-të i monitorimit është hartuar në pajtim me kushtet e referimit të shtyllës së III-të të UNMIK-ut-OSBE për Ndërtimin e Institucioneve të Monitorimit të Kuvendit të Kosovës, të datës 26 nëntor 2002, dhe monitorimin e zbatueshmërisë së Rregullores së Punës, të miratuar në seancën plenare më 20 maj 2005, të amendamentuar në seancën plenare më 1-2 qershor 2006 dhe në seancën plenare të radhës, më 18 shtator 2007.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka monitoruar shtatë seanca të rregullta plenare, më 12-13 tetor, më 29 tetor, 2 nëntor, 19 nëntor, më 23 nëntor, më 26 nëntor, më 3 dhjetor, më 18 dhe 29 dhjetor, si dhe një seancë të jashtëzakonshme të mbajtur më 17 tetor, si dhe dhjetë takime të Kryesisë së Kuvendit mbajtur; më 22 shtator, më 7 tetor, më 20 tetor, më 27 tetor, më 3 nëntor, më 10 nëntor, më 17 nëntor, më 1 dhjetor, më 15 dhjetor, dhe më 24 dhjetor.

2. Përmbledhje

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 12 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi, (Partia Demokratike e Kosovës-PDK) dhe anëtari i Kryesisë Z. Sabri Hamiti, (Lidhja Demokratike e Kosovës)

- Gjashtëdhjetë e tetë deputetë ishin të pranishëm në seancën e datës 12 tetor.¹
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës më 12 tetor:
 - Pyetjet për qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Organizimin në Sindikata (Me kërkesë të komisionit funksional, projektligji u tërhoq nga agenda me 30 vota për dhe 27 kundër)
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Masat Doganore për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale. (Projektligji u aprovua në parim me 58 vota për dhe 2 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2008 (Raporti u miratua me 39 vota për dhe 31 kundër)

¹ Kjo shifër është dhënë nga Kryetari i Kuvendit në fillim të seancës. Megjithatë, kjo shifër nuk përputhet me numrin e përgjithshëm të votave të pikave më poshtë sepse nuk përfshin abstenimet dhe numrin e deputetëve që fare nuk e deklarojnë votën e tyre.

- Shqyrtim i projekt strategjisë kundër korrupsionit për 2009-2011 (Projekt strategjia u aprovua me 36 voto për dhe 26 kundër)
- Debat për çështje ekonomike në Kosovë, si dhe marrëdhëniet ekonomike të Kosovës me vendet tjera.
(Debati u realizua me kërkesën e grupit parlamentar të LDD-së. Debatin e hapi Z. Lulzim Zeneli, sponsorues, i cili u pasua nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe disa deputetë tjerë të parlamentin. Debatin gjithashtu e përmbylli Z. Zeneli.)
- Shqyrtim i raportit mbi monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbeturina (Raporti u aprovua me 80 vota për dhe një votë kundër)
- Shqyrtim i rekomandimit të komisionit *ad hok* për emërtimin e anëtarëve në bordin e Radio the Televizionit të Kosovës (RTK)²
(Emërtimet u aprovuan me 61 vota për dhe 11 vota kundër.)
- Njoftim rreth zëvendësimit të anëtarëve të komisionioneve nga radhët e AKR-ës.

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës më 13 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit të Kosovës Z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i Kryesisë Z. Ibrahim Gashi (Aleanca Kosova e Re-AKR)

- Gjashtëdhjetë e shtatë anëtarë ishin të pranishëm në seancën plenare të datës 13 tetor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 13 tetor:
 - Shqyrtim i raportit të Qeverisë së Kosovës për shpenzimet buxhetore për periudhën janar-qershor 2009.
 - Shqyrtim i rekomandimit të komisionit për buxhet dhe financa për shpenzimet e Kuvendit të Kosovës për periudhën janar-qershor 2009.
(Sipas kërkesës së komisionit për buxhet dhe financa të dy raportet u shqyrtuan dhe votuan si një pikë e vetme e agjendës. Të dy raportet u aprovuan me 44 vota për, dhe 19 vota kundër)
 - Shqyrtimi i raportit vjetor të Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm për vitin 2008.
(Kuvendi diskutoi raportin, por votimi i tij u shty për shkak të mungesës së kuarumit. Për më shumë të dhëna shiqo më poshtë pjesën e titulluar “Kuormi”.

Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës më 17 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit të Kosovës Z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i kryesisë Z. Xhavit Haliti (PDK)

- Tetëdhjetë e shtatë deputet ishin të pranishëm në seancën plenare të 17 tetorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 17 tetor:
 - Ratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.
(Marrëveshja u ratifikua me 81 vota për dhe 3 vota kundër.)

Seanca Plenare të Kuvendit të Kosovës më 29 tetor e kryesoi nga Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi, dhe nga anëtari i Kryesisë Z. Eqrem Kyeziu (LDK).

- Gjatëdhjetë e dy deputet ishin të pranishëm në seancën plenare të majtur më 29 tetor dhe 2 nëntor.
- Çështjet kryesore nga agjenda e seancës plenare më 13 tetor:

² Anëtarët e rinjë të bordit të RTK-së, të emëruar nga Kuvendi, janë Ali Podrimja, Arif Bozaxhi, Aleksandar Janicevic, Avni Lindita Tahiri, Naime Beqiraj, Rrahman Paqarizi, Shemsi Sylja dhe Shukrija Gashi.

- Pyetjet për qeverinë për përgjegje me gojë.
- Shqyrtim i raportit vjetor të Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm për vitin 2008. (Raporti u miratua me 55 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Civil. (Projektligji u miratua në parim me 60 vota për dhe një votë kundër)
- Shqyrtimi i parë Projektligjit për Pagat e Shërbyesëve Civil. (Projektligji u miratua në parim me 65 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës. (Projektligji u miratua në parim me 55 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Financimin e Partive Politike. (Projektligji u miratua në parim me 57 vota për dhe 3 vota kundër.)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. (Projektligji u miratua në parim me 58 vota për dhe asnjë votë kundër)
- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimet Postare. (Projektligji u miratua në parim me 59 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtim i raportit mbi monitorimin e implementimit të Ligjit Penal për të Mitur, të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2004/8.) (Raporti u miratua me 59 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtim i rekomandimit të komisionit për ekonomi, tregëti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion në lidhje me përmirësimin e referencave të ligjit për Gazin Natyror.³ (Rekomandimi u miratua me 58 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtim i mocionit të paraqitur nga Z. Arsim Rexhepit (LDK), dhe përkrahur nga anëtarë të tjerë, në lidhje me formimin e një komisioni hulumtues për vlerësimin e shpenzimeve të RTK-së. (Mocioni u refuzua, me 9 vota për dhe 19 vota kundër, si dhe nëntë abstenime.)
- Shqyrtim i rekomandimit të komisionit për legjislacion dhe gjyqësi për emërtimin e anëtarëve në komisionin e Provimit të Jurisprudencës⁴ (Kuvendi miratoi njërin nga emërimet, ndërsa dy të tjarat u hodhën poshtë.)
- Shqyrtim i propozimit për rikonfigurimin e komisioneve parlamentare (Propozimi u miratua me 59 vota për dhe 10 vota kundër.)

Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës më 19 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (PDK), dhe anëtari i kryesisë Z. Sabri Hamiti (LDK).

- Shtatëdhjetë e pesë anëtarë ishin të pranishëm në seancën Kuvendit të mbajtur më 19 nëntorë.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 19 nëntor:
 - Pyetjet për qeverinë për përgjegje gojore.
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Borxhet Pulike (Projektligji u miratua në parim me 68 vota për dhe nëntë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për amendamentimin e ligjit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. (Projektligji u miratua me 65 vota për dhe asnjë votë kundër.)
 - Shqyrtimi i raportit vjetor të Bordit të Pavarur Mbikqyrës për vitin 2008. (Raporti u miratua me 57 vota për dhe asnjë votë kundër.)

³ Në emër të komisionit për ekonomi, tregëti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion Z. Et'hem Çeku (AAK) informoi seancën plenare se gjatë editimit të versionit final të ligjit për Gazin Natyror, miratuar nga Kuvendi më 30 shtator 2009, neni 22 është fshirë gabimisht gjë që e bën ligjin në fuqi të jofunksional.

Më tutje ai shtoi se rekomandimi i komisionit është që versionit final të ligjit për Gazin Natyror duhet rikthyer neni 22.

⁴ Në bazë të rekomandimit të Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi Kuvendi miratoi emërimin e Z. Rrustem Qehaja me 53 vota për dhe 4 vota kundër, ndërsa refuzoi emërimin e Z. Bardhyl Hasanpapaj me 15 vota për dhe 35 vota kundër, si dhe të Z. Ruzhdi Berisha me 21 vota për dhe 29 vota kundër.

- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për regjistrimin e popullatës dhe ekonomive familjare (Propozimi u miratua me 67 vota për dhe asnjë votë kundër.⁵)
- Shqyrtimi i propozimit të Trustit Pensional të Kosovës për uljen e tarfës për menaxhimin e kursimeve pensionale. (Propozimi u miratua me 54 vota për dhe asnjë votë kundër.)
- Shqyrtim i kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ndarjen e mjeteve shtesë për Zyrën e Revizorit të Përgjithshëm. (Kërkesa u miratua me 52 vota për dhe shtatë vota kundër.)
- Informatë mbi vendimin e Kryesisë së Kuvendit në lidhje me mocionin e Naim Rustemit⁶ për respektimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik nga ana e deputetëve të Kuvendit. (Për më shumë informacion, shiqo më poshtë paragrafin e titulluar “Kuvendi i Kosovës kërkoi nga deputetët e Kuvendit që të heqin dorë nga mandatet e dyfishta.)

Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës më 23 nëntor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i kryesisë Z. Eqrem Kryeziu (LDK).

- Tetëdhjetë e dy deputet qenë të pranishëm në seancën e 23 nëntorit.
- Çështjet kryesore nga agjenda e seancës plenare më 23 nëntor:
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për Buxhetin e Kosovës për 2010. (Projektligji u miratua në parim me 68 vota për dhe 14 vota kundër.)

Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës më 26 nëntor e kryesoi anëtari i kryesisë Z. Xhavit Haliti (PDK).

- Gjashtëdhjetë e tre deputet qenë të pranishëm në seancën plenare të 26 nëntorit.
- Çështjet kryesore nga agjenda e seancës plenare më 26 nëntor:
 - Debat për Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2009. (Debati u mbajt me kërkesën e komisionit për integritet evropian dhe të grupit parlamentar të LDD-së. Debatin e hapi Z. Lulzim Zeneli, sponsorues, i cili u pasua nga kryesuesi i komisionit për integritet evropian, përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe disa deputetë tjerë.

Seancën Plenare të Kuvendit të Kosovës më 4 dhjetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Z. Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i kryesisë Z. Xhavit Haliti (PDK).

- Katërdhjetë e tetë deputet qenë të pranishëm në seancë e 4 dhjetorit.
- Qështjet kryesore nga agjenda e seancës plenare më 4 dhjetor:
 - Pyetjet qeverisë për përgjegje gojore
 - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Klasifikimin dhe Verifikimin e Informacionit. (Çështja u shty për mungesë të kuorumit.)
 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Masat Antidamping. (Çështja u shty për mungesë të kuorumit.)

Seancën plenare të mbajtur më 18 dhjetor e ka kryesuar Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtari i kryesisë z. Ibrahim Gashi (AKR).

⁵ Ashtu siq është propozuar nga Qeveria, regjistrimi i popullatës dhe ekonomive familjare do të organizohet nga 30 marsi 2011 deri më 11 prill 2011.

⁶ Z. Naim Rustemi fillimisht është zgjedhur deputet në Kuvendin e Kosovës nga radhët e PDK-së, por më vonë ai ka braktisur PDK-në dhe ka vazhduar funksionin si deputet i pavarur në Kuvend.

- Gjashtëdhjetë e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën e 18 dhjetorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 18 dhjetor:
 - Pyetjet për qeverinë për përgjigje me gojë
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë (Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe asnjë votë kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për masat kundër dampngut (Projektligji është proceduar në shqyrtim të tretë me 46 vota për dhe 11 vota kundër. Për më tepër detaje, shih pasusin e tretë të “Procesi ligjberës”.)
 - Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Kosovës për Privatizim (AKP) për periudhën gusht 2008 – gusht 2009 (Raporti vjetor i AKP-së është miratuar me 40 vota për dhe 14 vota kundër.)

Seancën plenare të mbajtur më 29 dhjetor e ka kryesuar Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi (PDK) dhe anëtar i kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Tetëdhjetë e tre deputetë ishin të pranishëm në seancën e 29 dhjetorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare më 29 dhjetor:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2010 (Projektligji është miratuar me 66 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për tatimin në vlerën e shtuar (Projektligji është miratuar me 59 vota për dhe 23 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për tatimin në fitim (Projektligji është miratuar me 60 vota për dhe 12 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për tatimin në të ardhurat personale (Projektligji është miratuar me 52 vota për dhe 14 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (Projektligji është miratuar me 56 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për borxhet publike (Projektligji është miratuar me 56 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit kundër korrupsionit (Projektligji është miratuar me 54 vota për një votë kundër.)
 - Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për punë të brendshme dhe siguri për afat shtesë për shqyrtimin e projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Kërkesa është miratuar me shumicë votash për dhe asnjë votë kundër.)

1. Praktikrat dhe punimet parlamentare në seancat e Kuvendit

Procesi ligjberës

- Projektligji për tatimin në vlerën e shtuar është miratuar shtatë muaj pas shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 27 maj. Projektligji për tatimin në fitim është miratuar gjashtë muaj pas shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 9 korrik. Projektligji për tatimin në të ardhurat personale është miratuar pesë muaj pas shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 23 korrik. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike është miratuar pesë muaj pas shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 11 qershor. Projektligji kundër korrupsionit është miratuar katër muaj e gjysmë pas shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 9 korrik. Projektligji për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike dhe Projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë intelektuale është miratuar dy muaj pas shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 12 tetor. Projektligji për borxhet publike është miratuar gjashtë javë pas shqyrtimit të tij të parë në seancën

plenare të mbajtur më 19 nëntor. Projektligji për buxhetin e Kosovës për 2010 është miratuar pesë javë pas shqyrtimit të tij parë në seancën plenare të mbajtur më 23 nëntor.

Koment: Rregulla 35.6 parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi.” Pesë nga projektligjet e lartpërmendura u miratuan nga Kuvendi shumë kohë pas kalimit të afatit të caktuar me rregullën 35.6 dhe komisionet funksionale përgjegjëse nuk kërkuan kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi, gjë që nuk ishte në pajtim me rregullën 35.6. Shumë raporte të mëparshme të monitorimit kanë vërejtur gjithashtu që komisionet e Kuvendit kanë vështirësi për t’i shqyrtuar dhe raportuar rekomandimet e tyre rreth projektligjeve brenda afatit të caktuar me rregullën 35.6. Prandaj, Kuvendi do të mund ta merrte në konsideratë angazhimin e më shumë punonjësve mbështetës dhe ekspertëve ligjorë për t’i ndihmuar komisionet që t’i shqyrtojnë projektligjet me kohë. Për më tepër, edhe komisionet duhet të përpiqen t’i shqyrtojnë projektligjet brenda afatit të përcaktuar duke u takuar më shpesh, nëse është e nevojshme, sesa një herë në javë apo në dy javë siç e bëjnë zakonisht. Për më tepër detaje rreth kësaj çështje, shih tabelën e bashkëngjitur me ligjet e miratuara në vitin 2009.

- Në mbledhjen e 24 dhjetorit, Kryesia e ka shqyrtuar kërkesën e komisionit për punë të brenshme dhe siguri për afatin shtesë për shqyrtimin e projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të njëten kërkesë e ka përfshirë në rendin e ditës të seancës së 29 dhjetorit, për miratim nga Kuvendi. Prandaj, gjatë seancës së 29 dhjetorit, Kuvendi e ka miratuar kërkesën e komisionit duke e vazhduar afatin për shqyrtimin e projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale deri më 31 janar 2010.

Koment: Rregulla 35.6 parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi”. Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale është miratuar në parim në seancën plenare të mbajtur më 29 tetor, kështu që komisioni e ka bërë kërkesën në pajtim me rregullën 35.6.

- Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit për masat kundër dampingut në seancën e 18 dhjetorit, kryesuesi i komisionit për legjislacion dhe gjyqësi, z. Bahri Hyseni (PDK) ka propozuar që projektligji në fjalë të shkojë në shqyrtim të tretë me arsyetimin që komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion, si komision funksional, kishte propozuar amendamente që e ndryshonin qëllimin e projektligjit. Z. Armend Zemaj (LDK) gjithashtu ka thënë që komisioni funksional kishte propozuar një numër të madh amendamentesh me të cilët e ka ndryshuar qëllimin e projektligjit në fjalë dhe është pajtuar që projektligji të shkojë në shqyrtim të tretë. Ndërsa, sipas z. Ardian Gjini (AAK) projektligji është hartuar shumë dobët nga qeveria dhe është dashur t’i kthehet qeverisë më herët. Prandaj, ai ka propozuar që projektligji për masat kundër dampingut të mos shqyrtohet më tej në Kuvend, por t’i kthehet qeverisë në ripunim. Znj. Myzejene Selmani (AKR), kryesuese e komisionit funksional, gjithashtu ka propozuar që projektligji t’i kthehet qeverisë në vend se të shkojë në shqyrtim të tretë. Mirëpo, argumenti i z. Hyseni ishte që projektligji nuk mund t’i kthehej qeverisë në këtë fazë sepse e kishte kaluar shqyrtimin e parë dhe e ka përsëritur propozimin e tij që projektligji të shkojë në shqyrtim të tretë në mënyrë që të rishikohen amendamentet në bashkëpunim me zyrën ligjore të Kuvendit. Prandaj, Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin që projektligji për masat kundër dampingut të shkojë në shqyrtim të tretë dhe i njëjti është miratuar me 46 vota për dhe dhjetë vota kundër.

Koment: Sipas rregullës 38, “Kuvendi mund të vendosë për ta paraqitur një projektligj, që nuk arrin të marrë numrin e duhur të votave në shqyrtimin e dytë, për një shqyrtim të tretë. Amendamentet që janë shqyrtuar dhe janë refuzuar në shqyrtimin e dytë, ose janë të ngjashme me këto amendamente, nuk do të propozohen përsëri.” Prandaj, Kuvendi është dashur së pari të

votojë për amandamentet e propozuara dhe për projektligjin në tërësi dhe nëse projektligji në shqyrtim të dytë nuk do të merrte numrin e duhur të votave, atëherë ta paraqesë për shqyrtim të tretë.

- Në mbledhjen e 3 nëntorit, kryesia e ka shqyrtuar kërkesën e z. Riza Smaka (AKR) për ta udhëzuar Qeverinë që ta hartojë projektligjin për marrëdhëniet juridike me element ndërkombëtar.⁷ Kryesia ka vendosur që të kërkojë mendimin e Qeverisë. Sidoqoftë, Qeveria ende nuk e ka dhënë mendimin e vetë lidhur me këtë çështje.

Koment: Vendimi i kryesisë ishte në pajtim me rregullën 34.1, e cila parasheh që “Në rastet kur deputeti i Kuvendit ia paraqet Zyrës për Propozime dhe Parashtrësa një mocion që Kuvendi ta udhëzojë Qeverinë ta përgatitë një projektligj, Kryesia kërkon mendimin e Qeverisë.”

Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për organizimin sindikal dhe projektligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale janë shpërndarë më 22 shtator. Prandaj, projektligjet janë shpërndarë 13 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të mbajtur më 12 tetor.

Projektligji për pagat e nëpunësve civil është shpërndarë më 5 maj, projektligji për shërbimin civil është shpërndarë më 6 maj, projektligji për mërgatën e Kosovës është shpërndarë më 8 tetor, projektligji për financimin e subjekteve politike dhe projektligji për shërbimet postare janë shpërndarë më 14 tetor, dhe projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale është shpërndarë më 19 tetor. Prandaj, projektligjet janë shpërndarë 95, 94, 14, dhjetë, përkatësisht shtatë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të mbajtur më 29 tetor.⁸

Projektligji për borxhet publike është shpërndarë më 21 tetor dhe projektligji për hetimin parlamentar është shpërndarë më 30 tetor. Prandaj, projektligjet janë shpërndarë 20, përkatësisht 13 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të mbajtur më 19 nëntor.

Projektligji për buxhetin e Kosovës për vitin 2010 është shpërndarë më 6 nëntor. Prandaj, projektligji është shpërndarë dhjetë ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 23 nëntor.

Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë është shpërndarë më 18 nëntor. Prandaj, projektligji është shpërndarë 20 ditë pune para shqyrtimit të tij të parë në seancën plenare të mbajtur më 18 dhjetor.

Koment: Rregulla 35.1 parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Prandaj, pesë nga projektligjet e lartpërmendura – projektligji për shërbimin civil, projektligji për pagat e nëpunësve civil, projektligji për borxhet publike, projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë dhe projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale – nuk janë shqyrtuar në shqyrtimin e parë sipas Rregullës 35.1. Projektligji për shërbimin civil, projektligji për pagat e nëpunësve civil, projektligji për borxhet publike dhe projektligji për klasifikimin e

⁷ Ligji i propozuar për hartim nga z. Smaka është përgjithësisht i njohur me dy terme – *konflikti i ligjeve* dhe *e drejta ndërkombëtare private*. Termi *konflikti i ligjeve* kryesisht përdoret në sistemin juridik të së Drejtës Zakonore, ndërsa termi *e drejta ndërkombëtare private* përdoret në sistemin juridik civil apo kontinental.

⁸ Shpërndarja e projektligjit për pagat e nëpunësve civil dhe projektligjit për shërbimin civil nuk e përfshin pushimin zyrtar veror të Kuvendit, i cili ka ndodhur prej 1 gusht deri më 14 shtator. Sesioni pranveror i Kuvendit fillon të hënën e tretë të janarit, ndërsa sesioni vjeshtor fillon të hënën e dytë të shtatorit. Si rrjedhojë, sesioni vjeshtor i Kuvendit në vitin 2009 ka filluar më 14 shtator.

informatave dhe verifikimin e sigurisë janë shqyrtuar në shqyrtimin e parë më shumë se tri javë pune pas shpërndarjes së tyre, kurse shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale është mbajtur më herët se dhjetë ditë pune pas shpërndarjes së tij. Sidomos, shqyrtimi i parë i projektligjit për shërbimin civil dhe projektligjit për pagat e nëpunësve civil e ka tejkaluar së tepërmi afatin dhe si pasojë e ka vonuar miratimin e këtyre projektligjeve. Prandaj, është e rëndësishme që të ketë planifikim më të mirë të shqyrtimeve të para të projektligjeve në mënyrë që të mos vonohet miratimi i tyre.

Kuorumi

- Gjatë seancës plenare të mbajtur më 13 tetor, gjegjësisht në fund të debatit për raportin vjetor të Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm (ZRP) për vitin 2008, Kryetari i Kuvendit konstatoi se 55 deputetë ishin të pranishëm në sallë dhe se nuk ishte numri i mjaftueshëm për të votuar për raportin. Prandaj, Kryetari i Kuvendit e shtyu votimin e raportit të ZRP-së për seancën e ardhshme për shkak të mungesës së kuorumit. Në fillim të seancës së mbajtur më 29 tetor, Kuvendi ka votuar për raportin e ZRP-së dhe e ka miratuar me 55 vota për dhe një votë kundër.

Në fillim të seancës së mbajtur më 4 dhjetor, kryesuesi i seancës konstatoi se 48 deputetë ishin të pranishëm në sallë dhe se seanca mund të vazhdonte me pikën e parë të rendit të ditës – pyetjet për qeverinë për përgjigje gojore, pasi që nuk kërkonte votim. Pas përfundimit të pikës së parë, kryesuesi kishte konstatuar se vetëm 55 deputetë ishin të pranishëm në sallë. Pasi që nuk kishte kuorum për të vazhduar me pikën tjetër të rendit të ditës – shqyrtimi i parë projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë, e cila kërkonte votim, kryesuesi bëri një pauzë për t’iu dhënë kohë deputetëve tjerë të vijnë në seancë. Sidoqoftë, pas pauzës, vetëm 41 deputetë u kthyen në sallë dhe kryesuesi i shtyu dy pikat e mbetura për seancën e radhës.

Koment: Vendimi i Kryetarit të Kuvendit për ta shtyer votimin e raportit të ZRP-së në seancën plenare të mbajtur më 13 tetor dhe dy pikat e mbetura të seancës plenare të mbajtur më 4 dhjetor ishte në pajtim me rregullën 31.3 të rregullores, e cila parasheh që “vendimet që merren në mbledhjet e Kuvendit janë të vlefshme në qoftë se në kohën kur merren kanë qenë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit”.

Shtyerja e pikave të rendit të ditës për shkak të mungesës së kuorumit, në veçanti kur është rasti me projektligjet siç ka ndodhur në seancën e mbajtur më 4 dhjetor, shkakton vonesa të panevojshme në procesin ligjvënës të Kuvendit. Edhe raportet e mëparshme të monitorimit kanë bërë fjalë për situatat e ngjashme, kur pikat e rendit të ditës në seanca shtyheshin si pasojë e mungesës së kuorumit duke shkaktuar vështirësi në menaxhimin e seancave plenare. I rekomandohet kryesisht së Kuvendit dhe shefave të grupeve parlamentare ta adresojnë çështjen e mungesës së deputetëve në seanca plenare në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja më e mirë e tyre dhe të shmangen situatat e tilla.

Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve

- Në seancën e mbajtur më 12 tetor, Kuvendi e ka miratuar raportin me rekomandime të Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbeturina të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2006/31. Raporti me rekomandime është miratuar me 80 vota për. Ndërsa, në seancën e mbajtur më 29 tetor, Kuvendi e ka miratuar raportin me rekomandime të Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit Penal për të Mitur. Ky raport është miratuar me 59 vota për dhe asnjë votë kundër.

Koment: Rregulla 53.1 parasheh që “çdo komision brenda fushës së tij të përgjegjësive ka autoritet për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit nga Qeveria e Kosovës ose nga ministria përkatëse.” Rregulla 53.1 më tej specifikon që “për ta ushtruar autoritetin e dhënë më lart, komisionet: a) bëjnë kontrolle dhe studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi për çështje të

fushëveprimit të tyre, si zbatohen ato dhe propozojnë masa për raste konkrete; b) përgatisin një listë që përmban detaje teknike të ligjit; c) ushtrojnë kontroll të veprimtarisë së përgjithshme të ministrisë përkatëse; dhe d) raportojnë me shkrim dhe me gojë një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit.” Prandaj, raportimi i Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor mbi zbatimin e Ligjit për Mbeturina dhe raportimi i Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi mbi zbatimin e Ligjit Penal për të Mitur ishte në pajtim e rregullën 53.1. Kjo ishte hera e parë që Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor ka kryer një aktivitet mbikëqyrës në kontekstin e zbatimit të ligjeve.⁹ Ndërsa, raportimi i lartpërmendur i Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi mbi zbatimin e ligjeve ishte i dytë në vitin 2009, gjë që është për t'u lëvduar.

Gjatë vitit 2009, tre komisione tjera kanë mbikëqyrur dhe i kanë raportuar Kuvendit lidhur me zbatimin e ligjeve, që është përmirësim në krahasim me vitin e kaluar, kur vetëm Komisioni për buxhet dhe financa kishte mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Auditimin e Brendshëm të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2007/19.¹⁰ U rekomandohet fuqimisht edhe komisioneve tjera të mbikëqyrin dhe t'i raportojnë Kuvendit lidhur me zbatimin e ligjeve të paktën një herë në vit, siç kërkohet me rregullore.

Kryesia e Kuvendit kërkon nga deputetët të heqin dorë nga funksionet e dyfishta

- Më 29 tetor, z. Naim Rrustemi ka dorëzuar një kërkesë, me të cilën kërkonte nga kryesia e Kuvendit të sigurojë respektimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike. Në kërkesën e tij, ai pohonte se disa deputetë kishin shkelur Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike dhe Ligjin Kundër Korrupsionit¹¹ duke ushtruar funksione, të cilat janë të ndaluara për deputetët e Kuvendit. Për më tepër, ai kërkoi nga kryesia që të merrë masa kundër atyre deputetëve që kishin shkelur ligjet në fjalë.

Më 3 nëntor, kryesia ka diskutuar për kërkesën e z. Rrustemi dhe kishte vendosur të kërkojë nga të gjithë deputetët që po mbanin funksione tjera, përfshirë postet ekzekutive në administratë publike ose në ndërmarrje publike, të heqin dorë nga ato funksione tjera.¹² Megjithatë, kryesia nuk kishte caktuar afat për zbatimin e vendimit të saj.

Në fund të seancës të mbajtur më 19 nëntor, kryetari i Kuvendit tha që kishte marrë informatë nga Agjencioni Kundër Korrupsionit që ky Agjencion po i hetonte 19 deputetë nën dyshimin se po mbanin funksione të dyfishta. Në vazhdim, e ka komunikuar vendimin e kryesisë duke kërkuar nga të gjithë deputetët, që po mbanin funksionet tjera, të heqin dorë nga ato funksione në përputhje me legjislacionin përkatës.

Koment: Neni 13.2 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike parasheh që “gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare”.

⁹ Aktivitetet e mbikëqyrjes parlamentare lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbeturinat u kanë dhënë mundësi anëtarëve të komisionit në fjalë që t'i kuptojnë më mirë problemet e mjedisit në Kosovë dhe përgjegjësitë institucionale të agjencive të ndryshme rregullative dhe ekzekutive. Raporti, i hartuar në bashkëpunim me OSBE-në, është përgatitur si pjesë e procesit me pesë faza për mbikëqyrjen së zbatimit të Ligjit për Mbeturinat. Gjatë tërë procesit, OSBE-ja ka ofruar këshilla dhe ndihmë për kryerjen e të gjitha fazave të mbikëqyrjes.

¹⁰ Gjatë vitit 2009, përpos Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor; Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi gjithashtu ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2004/46; Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Veprimtarinë Private në Shëndetësi, të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2005/1; dhe Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit për Rrugët, të shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2007/35.

¹¹ Ligji Kundër Korrupsionit është shpallur me rregulloren e UNMIK-ut 2005/26.

¹² Vendimi i kryesisë ishte në përputhje me nenin 13 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike dhe nenet 26.1 dhe 27 të Ligjit Kundër Korrupsionit.

Term “zyrtar”, siç definohet në nenin 5 (i) të këtij ligji, i referohet Kryetarit të Kuvendit dhe deputetëve të Kuvendit. Për më tepër, sipas nenit 26.1 të Ligjit Kundër Korrupsionit, personi zyrtar profesionist nuk duhet të ushtrojë funksione administrative, mbikëqyrëse, apo përfaqësimi në shoqëritë tregtare, firma, institucione, kooperativa, fonde apo agjensione. Sidoqoftë, neni 26.2 i këtij ligji, parasheh që “si përjashtim nga paragrafi paraprak i këtij neni, personi zyrtar profesionist mund, si përfaqësues i organit të tij, të jetë anëtar bordi i një institucioni apo agjensioni publik, apo anëtar i bordit mbikëqyrës së një ndërmarrjeje publike, fondi publik apo shoqërie komerciale ku autoriteti qendror apo lokal është mbajtësi i aksioneve apo i të drejtave të tjera në bazë të të cilave merr pjesë në menaxhim apo kapital.” Prandaj, deputeti nuk mund të ushtrojë funksion administrativ, mbikëqyrës apo përfaqësues në një institucion apo agjension publik nëse nuk e përfaqëson Kuvendin. Kështuqë, kërkesa e kryesisë së Kuvendit drejtuar deputetëve për të hequr dorë nga funksionet tjera, siç është shpjeguar më lartë, është në pajtim me legjislacionin relevant.

2. Qasja

- Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Misioni i OSBE në Kosovë ka vazhduar të ketë qasje në seancat plenare, takimet e Kryesisë së Kuvendit dhe takimet e komisioneve që u shqyrtuan në këtë raport. Po ashtu, Misioni i OSBE në Kosovë ka pranuar kopjet e dokumenteve që i ka shqyrtuar Kuvendi, si dhe transkriptet e seancave plenare.

3. Transparenca

- Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Kuvendi i ka publikuar të dhënat e votimit elektronik të të gjithë seancave plenare, përveç seancës së jashtëzakonshme të mbajtur më 17 tetor dhe seancës së rregullt të mbajtur më 29 dhjetor, që është përmirësim në krahasim me periudhat e mëparshme.

Koment: Në seancën plenare më 15 shkurt 2008, Kryetari i Kuvendit kishte konstatuar që Kuvendi do të publikonte në ueb-faqen e tij të dhënat e votimit elektronik të vendimeve të marra në seancat plenare. Pas kësaj, Kuvendi filloi t'i publikojë të dhënat e votimit elektronik prej seancës së jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008, mirëpo jo në mënyrë të vazhdueshme. Prandaj, i rekomandohet Kuvendit që t'i publikojë të dhënat e votimit elektronik në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që të rritet transparenca e Kuvendit, posaçërisht llogaridhënia e deputetëve ndaj zgjedhësve të tyre.

- Radio Televizioni i Kosovës ka ofruar mbulim dhe transmetim të drejtpërdrejtë të seancave plenare që u shqyrtuan në këtë raport. Monitoruesit publikë dhe institucionalë kanë pasur qasje në seancat plenare. Kuvendi ka një ueb-faqe www.assembly-kosova.org, që përmban të dhënat biografike të deputetëve, informata për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, procesverbalet dhe transkriptet e seancave të Kuvendit dhe takimeve të komisioneve, kopjet e ligjeve, rezolutat dhe deklaratat e miratuara nga Kuvendi dhe informata tjera.

PËRFUNDON.

Ligjet e miratuara nga Kuvendi në vitin 2009

Nr	Emërtimi i ligjit	Komisioni funksional	Shqyrtimi i parë	Shqyrtimi i dytë	Kohëzgjatja
1	Ligji për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare ¹³	Komisioni për administratë publike, pushtet lokal dhe media	Në legjislturën e mëparshme	12.02.2009	Shih fusnotën 13..
2	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike të produkteve dhe vlerësim të konformitetit	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion	18.09.2008	12.02.2009	5 muaj
3	Ligji për ushqimin	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	26.02.2008	12.02.2009	11.5 muaj
4	Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	26.02.2008	12.02.2009	11.5 muaj
5	Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	26.02.2008	26.02.2009	12 muaj
6	Ligji për mbrojtjen e mjedisit	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	26.02.2008	26.02.2009	12 muaj
7	Ligji për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	18.09.2008	12.03.2009	6 muaj
8	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion	29.01.2009	12.03.2009	1.5 muaj
9	Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	28.03.2008	26.03.2009	12 muaj
10	Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme	Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi	Në legjislturën e mëparshme	26.03.2009	Shih fusnotën 13..
11	Ligji për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës	Komisioni për punë të jashtme	29.01.2009	16.04.2009	2.5 muaj
12	Ligji për zonat ekonomike	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion	29.01.2009	30.04.2009	3 muaj

¹³ Ligji për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Ligji për të drejtën sendore janë miratuar nga Kuvendi i mëparshëm, mirëpo nuk janë shpallur nga PSSP-ja. Në qershor të vitit 2008, Kuvendi ka miratuar një mocion procedural mbi tërheqjen dhe ndryshimin e ligjeve të pashpallura në procedurë të veçantë.

13	Ligji për produktet biocide	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	22.01.2009	27.05.2009	4 muaj
14	Ligji për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe organizatat e grupit të Bankës Botërore	Komisioni për buxhet financa	28.05.2009	29.05.2009	1 ditë
15	Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	06.11.2008	11.06.2009	7 muaj
16	Ligji për partneritetet publiko-private dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion	30.07.2008	25.06.2009	11 muaj
17	Ligji për lizingun	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion	06.11.2008	25.06.2009	7.5 muaj
18	Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore	Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi	12.03.2009	25.06.2009	3.5 muaj
19	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion	12.03.2009	25.06.2009	3.5 muaj
20	Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore	Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi	Në legjislaturën e mëparshme	25.06.2009	Shih fusnotën 13...
21	Ligji për dhënien e lejes për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës	Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale	12.03.2009	10.07.2009	4 muaj
22	Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar	Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi	16.04.2009	10.07.2009	3 muaj
23	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/17 për prokurim publik të ndryshuar me Ligjin nr. 02/L-99	Komisioni për buxhet dhe financa	09.07.2009	24.07.2009	2 javë
24	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009	Komisioni për buxhet dhe financa	23.07.2009	24.07.2009	1 ditë
25	Ligji për auditimin e brendshëm	Komisioni për buxhet dhe financa	29.01.2009	17.09.2009	8 muaj
26	Ligji për armët	Komisioni për siguri dhe punë të brendshme	16.04.2009	17.09.2009	5 muaj

27	Ligji për rendin dhe qetësinë publike	Komisioni për siguri dhe punë të brendshme	16.04.2009	17.09.2009	5 muaj
28	Ligji për standardizim	Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion	14.05.2009	30.09.2009	4.5 muaj
29	Ligji për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë	Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport	14.05.2009	30.09.2009	4.5 muaj
30	Ligji për gazin natyror	Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor	29.01.2009	02.11.2009	9 muaj
31	Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 02-L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik	Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi	11.06.2009	19.11.2009	5 muaj
32	Ligji për tatimin në vlerën e shtuar	Komisioni për buxhet dhe financa	27.05.2009	29.12.2009	7 muaj
33	Ligji për Agjencinë kundër korrupsionit	Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi	10.07.2009	29.12.2009	5.5 muaj
34	Ligji për tatimin në të ardhurat personale	Komisioni për buxhet dhe financa	27.04.2009	29.12.2009	8 muaj
35	Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave	Komisioni për buxhet dhe financa	09.07.2009	29.12.2009	5.5 muaj
36	Ligji për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale	Komisioni për buxhet dhe financa	12.10.2009	29.12.2009	2.5 muaj
37	Ligji për borxhet publike	Komisioni për buxhet dhe financa	19.11.2009	29.12.2009	1 muaj e 10 ditë
38	Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010	Komisioni për buxhet dhe financa	23.11.2009	29.12.2009	1 muaj